



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Arsimit dhe Shkencës
Ministarstvo Obrazovanja i Nauke / Ministry of Education and Science

Ministria e Arsimit dhe Shkencës, duke u bazuar në Ligjin nr. 02/L-67 për Botimin e teksteve shkollore, mjeteve mësimore, lektyrës shkollore dhe të dokumentacionit pedagogjik, Udhëzimin Administrativ 8/2022 “Dokumentacioni shkollor në arsimin parauniversitar” dhe vendimin nr.2-2740, të datës 23.06.2026 për caktimin e kushteve dhe kriterëve për botimin e dokumentacionit shkollor parauniversitar, shpall:

K O N K U R S
PËR BOTIMIN E DOKUMENTACIONIT SHKOLLOR

1. Kushtet dhe Kriteret për botimin e dokumentacionit shkollor parauniversitar:

1.1. Kushtet e ofrimit të shërbimit

- 1.1.1. Aplikanti duhet të sigurojë materialin për plotësimin e dokumentacionit shkollor në formë fizike dhe elektronike për institucionet arsimore publike dhe private;
- 1.1.2. Aplikanti duhet të sigurojë që dokumentacioni shkollor i prodhuar dhe i furnizuar të jetë në përputhje të plotë me mostrat e paraqitura në fazën e aplikimit; çdo ndryshim i dokumentacionit mund të bëhet vetëm me kërkesë dhe/ose me miratim paraprak të Ministrisë;
- 1.1.3. Aplikanti duhet të sigurojë që mostrat, dhe rrjedhimisht dokumentacioni shkollor, të jenë në përputhje të plotë me përmbajtjen, formën, cilësinë, dizajnin dhe specifikimet teknike të përcaktuara me legjislacionin në fuqi;
- 1.1.4. Aplikanti duhet të garantojë botimin e dokumentacionit brenda afateve të para-përcaktuara kohore.

1.2. Kriteret e kualifikimit të aplikantëve janë:

- 1.2.1. Të jetë operator ekonomik ose grup i operatorëve ekonomikë i regjistruar në Republikën e Kosovës, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- 1.2.2. Operatori ekonomik ose operatori ekonomik udhëheqës, në rast të grupit të operatorëve ekonomikë, duhet të jetë shtëpi botuese që merret me botimin e teksteve shkollore, mjeteve mësimore, lekturës shkollore dhe dokumentacionit pedagogjik;
- 1.2.3. Aplikanti duhet të dëshmojë se disponon certifikata të vlefshme për standardet ISO 9001:2015 dhe ISO/IEC 27001:2022 në fazën e aplikimit. Në rast të skadimit të afatit të vlefshmërisë së certifikatave, aplikanti duhet të sigurojë ripërtëritjen e tyre, duke garantuar mbulueshmëri të pandërprerë gjatë gjithë periudhës së realizimit të shërbimit;

1.2.4. Aplikanti duhet të dëshmojë se dokumentacioni shkollor përkatës pajiset me hologram sigurie, shtyp me dritë ultravjollcë (UV) dhe vulë të thatë metalike *emboss*.

1.3. Dosja e aplikimit do të përmbajë:

1.3.1. Kopja e dosjes së aplikimit duhet të përmbajë tri pjesë:

1.3.1.1. Pjesa e parë: Dokumentacioni administrativ;

1.3.1.2. Pjesa e dytë: Mostrat e dokumentacionit shkollor;

1.3.1.3. Pjesa e tretë: Oferta financiare.

1.4. Dokumentacioni administrativ duhet të përmbajë:

1.4.1. Certifikatën e regjistrimit të aplikantit, duke dëshmuar: emrin, statusin dhe fushëveprimtarinë. Në rast të konsorciumeve, aplikanti duhet të ofrojë certifikatën e regjistrimit të të gjithë operatorëve ekonomikë.

1.4.2. Në rastin e grupeve të operatorëve ekonomikë, aplikanti duhet të ofrojë marrëveshjen e konsorciumit të nënshkruar nga të gjithë anëtarët, ku përcaktohet udhëheqësi/përfaqësuesi i autorizuar i grupit, si dhe rolet dhe përgjegjësitë e secilit anëtar për realizimin e shërbimit.

1.4.3. Vërtetimin nga Administrata Tatimore për përmbushjen e detyrimeve tatimore. Në rast të konsorciumeve, aplikanti duhet të ofrojë vërtetimin për secilin anëtar të konsorciumit.

1.4.4. Vërtetimin nga Gjykata se pronari/ët dhe personi i autorizuar nuk janë nën hetime. Në rast të konsorciumeve, aplikanti duhet të ofrojë vërtetimet përkatëse për secilin anëtar të konsorciumit.

1.4.5. Deklaratën nën betim – e nënshkruar dhe vulosur nga aplikanti, që vërteton se të gjitha të dhënat e deklaruara janë të sakta. Në rast të konsorciumeve, aplikanti duhet të ofrojë deklaratën nën betim të nënshkruar dhe vulosur për secilin anëtar të konsorciumit.

1.5. Mostrat e dokumentacionit shkollor.

1.5.1. Aplikanti duhet të ofrojë nga një mostër për çdo artikull të dokumentacionit shkollor për kopje të aplikimit. Mostrat nuk guxojnë të përmbajnë ndonjë element identifikues të operatorit ekonomik ose të grupit të operatorëve ekonomikë. Mostrat duhet të dorëzohen për artikujt si:

1.5.1.1. Libri i Klasës. Libri i Klasës duhet të punohet me kopertinë të fortë, me mbështjellës special prej pëlhure (e jo letre).

1.5.1.2. Libri Amë. Libri Amë duhet të punohet me kopertinë të fortë, me mbështjellës special prej pëlhure (e jo letre).

1.5.1.3. Libri për regjistrimin e nxënësve në klasën e parë;

1.5.1.4. Dëftesa;

1.5.1.5. Libreza e nxënësve. Libreza shkollore duhet të jetë me material PVC folie 0.30 mm, të ketë lidhje speciale dhe të jetë me qepje. Kopertina duhet të ketë brenda kartonin 1.25 mm.

1.5.1.6. Diplomat;

1.5.1.7. Certifikata e profesionit;

1.5.1.8. Certifikata e maturës shtetërore;

1.5.1.9. Regjistri i diplomave të lëshuara; dhe

1.5.1.10. Regjistri i certifikatave të maturës shtetërore.

1.6. Oferta financiare

1.6.1. Oferta financiare ofrohet me çmimin për njësi të artikullit të dokumentacionit, sipas tabelës në vijim. Oferta financiare nuk guxon të përmbajë asnjë element identifikues të operatorit ekonomik ose të grupit të operatorëve ekonomikë.

Nr.	Lloji i dokumentacionit shkollor	Çmimi për njësi (euro)
-----	----------------------------------	------------------------

1	Libri i klasës	
2	Libri amë	
3	Libri për regjistrimin e nxënësve në klasën e parë	
4	Dëftesa	
5	Libreza e nxënësve	
6	Diploma	
7	Certifikata e profesionit	
8	Certifikata e maturës shtetërore	
9	Regjistri i diplomave të lëshuara	
10	Regjistri i certifikatave të maturës shtetërore	

1.7. Dorëzimi i dosjes së aplikimit

1.7.1. Aplikanti duhet të dorëzojë dy kopje të dosjes së aplikimit;

1.7.2. Forma e dorëzimit të dosjes së aplikimit:

1.7.2.1. Të gjitha kopjet e dosjes së aplikimit duhet të vendosen në një zarf ose paketim të vetëm. Zarf/paketimi nuk guxon të përmbajë asnjë element identifikues të operatorit ekonomik ose të grupit të operatorëve ekonomikë. Në rast se zarfi/paketimi përmban ndonjë element identifikues, aplikanti diskualifikohet automatikisht. Aplikanti është i obliguar që në zarf/paketim të vendosë një numër katërshifror sipas zgjedhjes së tij.

1.7.2.2. Brenda zarfit/paketimit të përmendur në pikën 2.1, secila kopje e dosjes së aplikimit duhet të vendoset në një zarf ose paketim të veçantë. Zarf/paketimi nuk guxon të përmbajë asnjë element identifikues të operatorit ekonomik ose të grupit të operatorëve ekonomikë. Në rast se zarfi/paketimi përmban ndonjë element identifikues, aplikanti diskualifikohet automatikisht. Aplikanti është i obliguar që në secilin zarf/paketim të vendosë të njëjtin numër katërshifror, të përcaktuar sipas pikës 2.1.

1.7.2.3. Brenda zarfit të përmendur në pikën 2.2, secila pjesë e dosjes së aplikimit duhet të vendoset në zarf ose paketim të veçantë.

1.7.2.4. Zarf që përmban pjesën e parë të aplikimit duhet të ketë mbishkrimin: “Numri katërshifror si në pikën 2.1 – Dokumentacioni administrativ”.

1.7.2.5. Zarf që përmban pjesën e dytë të aplikimit duhet të ketë mbishkrimin: “Numri katërshifror si në pikën 2.1 – Mostrat”.

1.7.2.6. Zarf që përmban pjesën e tretë të aplikimit duhet të ketë mbishkrimin: “Numri katërshifror si në pikën 2.1 – Oferta financiare”.

2. Aplikanti diskualifikohet automatikisht nëse:

2.1. Vendos shenja dalluese të identitetit të tij në mostrat e dokumentacionit shkollor ose në ofertën financiare;

2.2. Dokumentacioni administrativ nuk është i plotë ose nuk përmban dëshmi të mjaftueshme për përmbushjen e kriterëve të përcaktuara me këtë thirrje;

2.3. Mostrat e dokumentacionit shkollor nuk janë të plota ose nuk i përmbushin kërkesat e përcaktuara me këtë thirrje;

2.4. Oferta financiare nuk përmban çmimet për të gjitha pozicionet, në përputhje me tabelën e paraqitur në pikën C: Oferta financiare.

3. Operatori ekonomik apo grupi i operatorëve ekonomikë përzgjidhet për një periudhë prej tri vitesh shkollore, nga viti shkollor 2026/2027 deri në vitin shkollor 2028/2029. Në rast të ndryshimit të legjislacionit përkatës gjatë periudhës së vlefshmërisë së vendimit për aplikantin e përzgjedhur, do të zbatohen dispozitat e legjislacionit të ri.

4. Afati për aplikim është nga data 25.06.2026 deri më 09.07.2026, në orën 16:00.

5. Aplikanti duhet ta dorëzojë dosjen e aplikimit në Arkivin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.